



REPUBLIKA E KOSOVËS - NË UDHAJA KOSOVË	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	75/17
Nr. i fq. / Br. st	-12-
Data: / Datum	30.03.2017
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

EKSTRAKT

NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 12 JANAR 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Habib Mustafa, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Finesë Hajrizi

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të informimit publik dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – paraqiti sqarime lidhur me PZHK, duke njoftuar se janë konsultuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për emërtimin e këtij dokumenti dhe ceku se i kanë inkorporuar të gjitha instrukSIONET e marra nga ministria e cekur. **Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - si reagim kundër arrestimit të ish-Kryeministrit Ramush Haradinaj, lexoi një deklaratë ku u kundërshtua arrestimi i tij (në vazhdim e gjeni të plotë këtë deklaratë): Qytetarët, Qeveria Komunale dhe institucionet komunale të Komunës së Vushtrrisë janë tejet të shqetësuara me arrestimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, nga autoritetet franceze. Akti i ndalimit të gjeneralit Haradinaj dhe udhëheqësve të UÇK-së, i konsiderojmë se janë akte të papranueshme, duke pas parasysh edhe faktin se z. Haradinaj e ka dëshmuar para drejtësisë ndërkombëtare në dy raste pafajësinë e tij dhe po ashtu është përballur edhe me ndalesa të tjera të përkohshme, të cilat e kanë konfirmuar se fletarrestet serbe nuk kanë asnje bazë. Andaj, ne presim që z. Haradinaj të kthehet shumë shpejtë në Kosovë dhe po ashtu presim që edhe Qeveria Franceze të ketë parasysh se këto fletarreste janë krejtësisht politike. Ky është një akt politik dhe antishqiptar, që synon destabilizimin e Kosovës dhe rajonit. U bëjmë thirrje autoritetet franceze që t'i mundësojnë kryetarit të AAK-së, z. Ramush Haradinaj, që të vazhdojë udhëtimin e tij i papenguar, e po ashtu kërkojmë nga autoritetet e BE-së dhe të shtetet e tjera evropiane që të mos pengojnë lëvizjen e lirë të autoritetet e Kosovës, sipas urdhëarresteve të paligjshme dhe politike të lëshuara nga Serbia. Kërkojmë që Qeveria e

Kosovës, e në veçanti Ministria e Punëve të Jashtme, të angazhohen urgjentisht që rastet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Vushtrri, 12 janar, 2017 Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe Qeveria Komunale.

Pas votimit të kësaj çështjeje, Kuvendi me vota unanime aprovoi deklaratën kundër arrestimi të ish-Kryeministrit Ramush Haradinaj nga ana e autoriteteve franceze.

Në përfundim të diskutimeve Kuvendi pas votimit me 30 vota "për" dhe 3 "abstenime" aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë 2016-2024.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se aprovimi i Planit Zhvillimor Komunal, ka marrë shumë kohë, në këtë rast përgëzoi qeverinë komunale, gjegjësisht Drejtoren e Urbanizmit për punën që ka bërë në hartimin e këtij plani. Në këtë relacion ceku se janë mbajtur mjaft takime publike lidhur me këtë dokument dhe shtoi se ky plan është një nga dokumentet më të rëndësishme i cili është bazë për zhvillimin ekonomik, social dhe infrastrukturor të komunës sonë. Për aprovimin e këtij plani janë përbushur kërkosat dhe elementet themelore, dhe nëse dikush mendon ndryshe, atëherë është mirë që të sjellë fakte për argumentimin e të kundërtës. Në përpikëri janë respektuar parimet e Ligjit të Planifikimit Hapësinor dhe të Udhëzimit Administrativ që buron nga ky ligj, duke filluar nga parimi demokratik që i bie që ky dokument është promovuar përmes mediave dhe diskutimeve publike. Ky dokument ka kaluar nëpër një transparencë të plotë dhe shprehu vullnetin e tij edhe njëherë që për shkak të peshës që ka ky dokument të aprovohet me konsensus të plotë politik. Pastaj ceku se ajo çka nuk i ka pëlqyer gjatë diskutimeve publike është fakti se palët e interesit ekskluzivisht kanë qenë të interesuara për pronat e tyre, e jo për atë se çka ka paraparë plani në brendinë e tij. Pastaj është respektuar parimi i përfshirjes ku është bërë përfshirja e objektivave për një zhvillim të qëndrueshëm, parimi i proporcionalitetit, hartimi i politikave të qarta që e mbrojnë mjedisin, si dhe tokën bujqësore, pyjet dhe burimet ujore, biodiversitetin dhe monumentet e trashëgimisë kulturore. Tutje shtoi se edhe hartuesit e këtij plani gjatë debateve publike kanë bërë thirrje që një rëndësi e veçantë t'iu kushtohet zonave të gjelbëta të qytetit. Kjo përfaktin se me privatizimet që janë bërë nga ana e AKP-së janë marrë tokat me rëndësi dhe tanë kur shtrohet çështja e ndërtimit të një objekti për nevojat e komunës, atëherë duhet që me mjete tona të blejë një hapësirë (parcelë) për ndërtimin e atij objekti. Në vazhdim ai theksoi që duhet të bëhen përpjekje që të ruhet ajo çka është e mundur për hir të gjeneratave të ardhshme, kjo përfaktin se nga paslufta e dimë të gjithë se është abuzuar mjaft shumë me tokën dhe pronën publike në përgjithësi, andaj apeloi që me aprovimin e këtij plani të bëhet prioritet i lartë ruajtja e tokës bujqësore. Pastaj parim parandalues, i cili nënkupton parandalimin e politikave që e degradojnë mjedisin dhe kjo duhet të jetë prioritet i autoriteteve komunale. Plani të cilin sot e kemi duke e diskutuar është konkret dhe është një bazë e mirë për hartimin e hartave zonale që është obligim ligjor që janë dokumente vijuese pas hartimit të PZHK-së, por edhe hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme. Në vazhdim theksoi se të gjitha pikat e parapara në këtë plan janë në harmoni me njëra tjetrën dhe në përputhshmëri me Ligjin e Planifikimit Hapësinor. Është e nevojshme që me këtë plan të adresohen nevojat tona, në mënyrë që të tejkalojen sfidat në kuadrin e implikimeve hapësinore. Gjatë hartimit të këtij plani ka pasur përparësi, mundësi, por ka pasur edhe rreziqe dhe sfida të mëdha kjo përfaktin e ditur që toka bujqësore është zënë me ndërtime gjithandjej, dhe në rrethana të tillë është vështirë që të hartohet një dokument ku do të ruheshin këto toka dhe mjedisi, kur dimë se kemi zënie të jashtëzakonshme të tokës bujqësore me

ndërtime. Në këtë plan janë të përfshira të gjitha fushat duke filluar nga fusha ekonomike, infrastruktura teknike dhe transporti, infrastruktura publike dhe sociale, mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri, asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe turistike. Tështo se nëse është bërë analiza e sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pandërtuara, atëherë duhet të kemi prioritet ruajtjen e tokës bujqësore, dhe sipërfaqeve të gjelbra, kur kemi parasysh se kemi trashëguar rrugë të ngushta, dhe nuk kemi pasur hapësirë që këto rrugë t'i zgjerojmë, pastaj kemi komunikacion të dendur, mungesë të stazave për këmbësorë dhe biciklistë, mandje importim dhe blerje të automjeteve të vjetruara që reflektojnë në ndotjen e automjeteve. Andaj si përfundim që këtyre gjërat t'u japim prioritet me këtë plan. Pastaj kur bëhet fjalë për zonat e gjelbra, atëherë ato duhet trajtuar konform ligjit duke e marrë për bazë parimin që hapësirat e gjelbra të janë në proporcione dhe përqindje për kokë banori, sidomos në qytete. Në këtë plan duhet të trajtohen edhe zonat apo vendbanimet rurale. Banimi është përfshirë në këtë plan zhvillimor, ku është dhënë gjendja ekzistuese e banimit dhe modelet e banimit, andaj duhet të vlerësohet se çfarë stilë të ndërtimit të banimit dëshirojmë të kemi në të ardhmen. Vendbanimet joformale shfrytëzimi i tokës, gjendja ekzistuese çfarë është, dhe mirë është që të gjithë ne të japim kontributin tonë në projekcionet për të ardhmen lidhur me trajtimin e tokës bujqësore.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se dokumentin të cilin jemi duke e trajtuar sot është njëri nga dokumentet më të rëndësishme komunale në tetë vitet e ardhshme, andaj ky dokument është dashur të miratohet me konsensus të plotë. Në vazhdim ai ceku disa vërejtje dhe sugjerime lidhur me dokumentin në fjalë, duke u shprehur se në përbërjen e komisionit për hartimin e këtij plani figuron emri i Fadil Haxhës ish-punëtor i komunës (i pensionuar në vitin 2014), tha se kjo duhet të përmirësohet, tek faqja 15 pika 1.4 ku thuhet se informata për kornizën strategjike janë marrë nga raportet sektoriale të të gjitha drejtive komunale, si dhe strategjite e tyre zhvillimore, kurse në PZHK këto nuk hasen askund apo të paktën nuk kemi numër të protokollit të këtyre raporteve. Në faqen 19, alineja 4 thuhet se janë formuar grupet punuese për demografi dhe çështje sociale, shfrytëzim të tokës dhe mjedisit, infrastrukturë teknike, zhvillim ekonomik, ndërsa nuk janë dhënë emrat e këtyre grupeve punuese. Në faqe 33 thuhet se infrastruktura teknike, në përgjithësi, si në zonën urbane, ashtu edhe në atë rurale është e dobët si në aspektin kualitativ ashtu edhe në atë kuantitativ, për këtë pyeti se mos vallë kaq dobët jemi duke i kryer këto projekte infrastrukturore. Trashëgimia kulturore dhe natyrore thuhet se është në shkatërrim e sipër këtu cila është e vërteta se kjo trashëgimi a po shkatërhohet njëmend apo jo. Në faqe 42 thuhet se furnizimi me ujë në Komunën e Vushtrrisë bëhet përmes ujësjellësit rajonal në Shipol të Mitrovicës dhe disa vendbanime furnizohen nga burime lokale. Kurse në fund të tekstit përmendet se është ndërtuar fabrika për përpunimin e ujit në fshatin Balincë, por nuk potencohet se kjo fabrikë tanë është lëshuar në funksion (kërkoi që kjo të përmirësohet). Faqe 59 ndotja e ajrit thuhet se ndotësit kryesorë janë "Trepça" në Mitrovicë dhe KEKU në Kastriot, por këtu duhet pasur parasysh se kompleksi Trepça nuk punon që nga viti 1999 dhe ky gjigand nuk mund të llogaritet si ndotës i ajrit. Kurse sa i përket KEK-ut ku ceket se në mënyrë indirekte gjatë erërave jugore, ndotja i përfshin fshatrat Stroc, Gllavatin, Mihaliq, Lumadh, Dumnicë e Poshtme dhe Beçuk, por këtu duhet të cekën edhe fshatrat Gracë, Stanoc i Poshtëm dhe Stanoc i Epërm si dhe Bivolaku dhe Zhilivoda si fshatra më afér kësaj fabrike, ndotës tjetër llogaritet edhe fabrika e "Llamkosit" që gjithashtu nuk punon. Faqe 72 trashëgimia arkitektonike në tabelën e monumenteve nuk është përfshirë kulla e "Zejnullah Begut" e cila është meremetuar, faqe 83 shfrytëzimi i tokës në komunë disa sipërfaqe duket se janë të vogla si p.sh "rrugët" 0,10, kurse shkollë 0,01 që i bie 1 ari. Për këtë pyeti se si ka mundësi që në sipërfaqe prej 1 ari të ndërtohet një shkollë. Në faqe 87 ku flitet për fondin e tokës bujqësore thuhet se në Komunën e Vushtrrisë do të humben rreth 800 ha tokë bujqësore kualitative, andaj me këtë pyeti se ku po mbetet strategjia për mbrojtjen e tokës bujqësore. Faqe 88 objektet me rëndësi të veçantë nga kjo listë duhet të hiqet objekti i TMK-së, dhe duhet të shtohen: Fabrika për përpunimin e ujit në fshatin Balincë, objekti i zjarrfikësve, fabrika për riciklimin e mbeturinave në fshatin Bukosh. Faqe 89, ku flitet për dobësi thuhet se sistemi i

ujitjes është në gjendje jo të mirë në vetë qendrën e Vushtrrisë dhe mungesa e ujësjellësit në pjesën dërrmuese të fshatrave, për këtë mendon se nuk është gjendja reale ashtu siç është paraqitur për arsyet së është investuar shumë në rrjetin e qytetit, por edhe fshatra dhe është shtri dhe po shtrihet rrejti i ri, po ashtu edhe kanalizimi fekal dhe atmosferik gjendet në gjendje jo të mirë. Në tekst të këtij dokumenti shkruan Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban dhe këtu duhet të hiqet shprehja urban sepse në këtë rast ne jemi duke diskutuar vetëm për Planin Zhvillimor Komunal. Pastaj sipas simbolit në legjendë shihet se në çdo shkollë ka edhe çerdhe gjë që nuk është e vërtetë. Infrastruktura rrugore dhe energetike në qytet, për këtë rrugore kemi të dhëna, kurse për infrastrukturën energetike nuk ka kurrfarë elementi qoftë në hartë apo në lexim, andaj këto dy segmente të infrastrukturës duhet të ndahen dhe të plotësohen edhe me të dhëna tjera. Mandej tek harta e zhvillimit ekonomik është përdorur termi “serrat për pemë” dhe kjo është e pakuptim përfaktin se serrat nuk përdoren për kultivimin e pemëve. Fabrika e patates “Vipa Çips” është pasqyruar në një vend jo të duhur. Tek harta e zhvillimit ekonomik dhe potencialet turistike është paraqitur fshati Akrashticë si potencial i madh turistik sidomos përgjueti, dhe kjo nuk është e vërtetë përfaktin se ky fshat është mjaft i banueshmëm andaj duhet të parashihet një vend tjetër përgjueti. Sistemi i ujites në komunën tonë, zonat nën komasacion në hartë janë paraqitur gabimisht sikur nga fshati Pantinë deri në Gracë të janë këto tokat nën komasacion, por edhe kjo nuk është e saktë sepse tokat nga fshati Pantinë e deri në fshatin Maxhunaj janë tokat nën sistemin e komasacionit, kurse pjesa tjetër është tokë bujqësore, por pa komasacion dhe kjo duhet të përmirësohet. Pastaj tek harta infrastruktura teknike mbledhja e mbeturinave në komunë këtu nuk është paraqitur fabrika për riciklimin e mbeturinave në fshatin Bukosh dhe propozoi që të gjitha hartat të janë më të dukshme dhe më të mëdha. Në fund në emër të grupit kuvendor të LDK-së tha se kur bëhet fjalë për zonën e tetë kanë vërejtje se është bërë një selektim joparimor përfaktin se në të kaluarën nga hyrja në qytet në mes të dy rrugëve asaj magjistrale dhe rrugës përgjitet e deri tek lumi “Tërstena” ka qenë zonë e paraparë përgjelbërim, ndërsa tani zonë e gjelbërimit ka mbetur vetëm pjesa afér lumit “Tërstena”, ndërsa aty në atë vend është paraparë të ndërtohet një qendër tregtare ku do të mund të punësoheshin 200 deri 250 persona. Andaj në këtë kontekst shtrohet pyetja a jemi ne përvzhvillim ekonomik apo jo, dhe ceku se si grup kuvendor janë që edhe kjo zonë d.m.th zona e tetë të parashihet përfndertim dhe zhvillim të bizneseve, ndërsa për zonë të gjelbër të gjendet ndonjë vend tjetër ose të mirëmbahet parku i qytetit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendorit – tha se vërejtjet dhe sugjerimet të cilat i ka dhënë grupi kuvendor i LVV-së, në mbledhjen e kaluar nuk janë inkorporuar në PZHK, andaj nuk është e logjikshme dhe e arsyeshme që prapë t'i përsërisim ato propozime kur ato nuk bëhen pjesë e këtij dokumenti. Pastaj çështja e zonës së tetë, ku kjo çështje është mjaft e “mjegulluar”, si dhe fakti se propozimet tona nuk janë marrë përbazë, atëherë grupei kuvendor i LVV-së do të votojë kundër këtij planit.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendorit – tha se është kundër këtij plani përfaktin se ky plan nuk është përvzhvillimin e komunës, sepse me këtë po humbin rreth 200 vende të punës, në një investim mbi 5,000.000 €, andaj atëherë nuk e kupton faktin se përsë veprohet kësijo sepse në fushatën zgjedhore kur kemi kërkuar votat e qytetarëve kemi premtuar se do punojmë përvzhvillim ekonomik të komunës. Në fund tha se në mbledhjen e kaluar ishte dhënë propozim që të gjitha grupet kuvendare do të takohen dhe do të arrijnë një konsensus lidhur me këtë dokument, por pasi kjo nuk ka ndodhur atëherë ai do të votojë kundër.

Agron Perçuku, anëtar i kuvendorit – tha se a janë plotësuar kriteret e parapara mbi parimet kryesore që duhet t'i plotësojë Plani Zhvillimor Komunal (Neni 4 i udhëzimit administrativ të MMPh- Nr. 112015 mbi elementet dhe kërkesat themelore përhartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal). Pjesa tekstuale e PZHK sipas nenit 5 të udhëzimit duhet të jetë: Hyrje në profilin e komunës, vlerësimi i gjendjes, korniza e zhvillimit hapësinor, priorititet strategjike të zhvillimit. Në këtë dokument janë të përfshira këto pjesë, por që ka paqartësi si në faqen 23 në fillim të tekstit ku thuhet, Kosova ka një sipërfaqe prej 10.907 km²

dhe vazhdon. Ajo është vend i mbyllur që kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi Serbinë. Të sqarohet çka do të thotë kjo vendi i mbyllur. Po në ketë faqe gati në fund të tekstit ku thuhet autostrada Merdarë - Prishtinë - Morinë nuk kalon nëpër territorin e Vushtrrisë, kjo s'ka nevojë të jetë sepse ka edhe shumë projekte tjera të rëndësishme të mëdha që nuk kalojnë për Vushtrri. Faqe 28, ku ceken emrat në një rast përdoret fjala *Mihakliq* (të evitohet ky gabim); faqe 32 te zhvillimi i barabartë thuhet: Për te gjitha pjesët e qytetit dhe për të gjitha grupet e popullsisë duhet të sigurohet mundësi e barabartë dhe përparësi për të gjitha zhvillimet (besoj që duhet të jetë komunës e jo qytetit) sepse kemi të bëjmë për PZHK - e jo për qytet; faqe 33, si të planifikojmë zhvillimin për të ardhmen në mënyrë që të arrihen standarde ndërkombëtare, transparenca, si dhe pjesëmarrja në vendimmarrje. (këtu ka pyetje s'ka përgjigje); faqe 43,44,46,56,57 e në faqet tjera përdoret –rekomandohet (konsideroj që shumë më adekuat kishte me qenë fjala planifikohet); faqe 44 këtu përmendën vendbanimet nga kalon magjistralja (të janë të renditura mirë); faqe 45 njëherit thuhet se janë 4 stacione hekurudhore, ndërsa numërohen vetëm 3- (të sqarohet më mirë sa stacione hekurudhore janë); faqe 54 te shërbimet jashtë sistemit të integruar kosovar (shëndetësor s'ka nevojë te përdoret fare.); faqe 55, në bazë të të dhënave qe ka Drejtoria për Ekonomi në Vushtrri gjatë vitit 2004 janë regjistruar 20 biznese të shërbimeve shëndetësore (a nuk kemi mundësi të shërbehem me të dhëna më të reja për këtë fushë apo të merrem para 12 viteve.); faqe 83, tabela shfrytëzimi i tokës rrugë 0,10 ha (a vetëm kaq kemi), shkolla 0.01 ha (a vetëm kaq kemi kur në faqen 49/50 thuhet se janë 55 objekte shkollore. Mulli uji sa e di është vetëm një në komunë e sipërfaqja e tij është 0.02 ha, Vreshta 27,63 ha (ku janë këto vreshta); faqe 147 ku thuhet planet hapësinore për zonat e veçanta do të hartohen (e jo kërkohet siç është në tekst), dhe për fund duhet të sqarohet një çështje në vijim nen 26, pika 3 Ligji për Planifikim Hapësinor Nr04/L-174, ku flitet për hartimin dhe harmonizimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor thuhet se komunat, të cilat posedojnë Planin zhvillimor komunal, Planin zhvillimor urban, Planet rregulluese Urbane, të miratuar nga ministria dhe kuvendet komunale janë të obliguara që brenda 15 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të hartojnë dhe aprovojnë hartën zonale të komunës në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Sipas asaj që e di komuna jonë kishte një Plan zhvillimor komunal, Plan zhvillimor urban dhe disa plane rregulluese urbane, çka u bë me to ku mbeten, pse nuk u bë plotësim-ndryshimi dhe përshtatja me ligj, ku botërisht dihet se Komuna e Vushtrrisë ne bazë të këtyre dokumenteve ka lëshuar leje për ndërtim.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se Drejtoria e Urbanizmit, është munduar të hartojë një plan zhvillimor në kuptimin e përgjithshëm për Komunën e Vushtrrisë. Tujte shtoi se në ato aspekte ku punohet mund edhe të bëhen gabime, mirëpo duhet të bëjmë përpjekje që të hartojmë një plan i cili është policentrik në kuptimin e zhvillimit të përgjithshëm të komunës sonë dhe jo që zhvillimi të jetë monocentrik. Dihet mirëfilli se vendimi për hapjen e diskutimit publik për këtë dokument është marrë në kuvend në muajin shkurt të vitit të kaluar dhe diskutimet janë mbajtur për këtë dokument, mirëpo Ministria e Pushtetit Lokal e kishte prishur vendimin e kuvendit pasi termi “*revidim*” nuk ishte nga viti 2009 nuk është pranuar dhe në atë kohë urgjentisht ishte thirrur një mbledhje në muajin korrik 2016, kurse Ministria e Ambientit më datë 21.07.2016 kishte marrë vendim me të cilin ishte aprovuar i tërë procesi i diskutimit dhe i zhvillimit të këtij projekti. Ndër të tjera në vendimin e ministrisë gjegjëse ishte kërkuar që t'i përbahemi të gjitha procedurave të parapara me ligj. Kjo duhet të apostrofohet për faktin se këtu sikur po kemi shhangje nga kjo sepse Komiteti për Politikë dhe Financa ka marrë një qëndrim që bie ndesh me pëlqimin e dhënë nga ministria e linjës lidhur me PZHK-në. Në vazhdim vlerësoi se duhet të inkorporohen në këtë dokument rekondimet e Komitetit Konsultativ për Urbanizëm për faktin se janë dhënë rekondime mjaft me rëndësi. Duke iu referuar faqes 83 të planit ku ceket se aeroporti që ka një sipërfaqe prej 5,14 ha dhe kjo nuk dihet se ku gjendet. Mandej një tjetër dobësi e cila është evidentuar edhe në këtë dokument është mungesa e ujësjellësit dhe këto projekte janë paraparë edhe me strategjitet e mëhershme për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës. Sistemi i kanalizimit të ujërave atmosferike dhe

fecale nuk është në gjendje të qëndrueshme. Mandej propozoi që tek ura e hekurit e cila është një urë mjaft e vjetruar ku kalojnë mjete me peshë të rëndë duhet të bëhen renovime me qëllim që mos të vijë tek ndonjë fatkeqësi. Pastaj rrejti elektrik i cili ndodhet në një gjendje jo të mirë, dhe për këtë është shumë e nevojshme që të bëhet përmirësimi në zgjerimin e trafove. Pastaj ai vlerësoi se temë bosht që duhet të trajtohet në Planin zhvillimor komunal, është çështja e zhvillimit ekonomik ku do të ulej numri i të papunëve dhe me këtë do të pengohej migrimi i qytetarëve në botën e jashtme, dhe ky dokument duhet të jetë bazë për adresimin e çështjeve sociale dhe ekonomike. Në relacion të aprovimt të këtij dokumenti ai vlerësoi se ky dokument nuk duhet të jetë me dy kuptime por duhet të kemi një version përfundimtar para se ky dokument të aprovohet. Pastaj ceku se në plan janë përfshirë shumë projekte, të cilat ndoshta nuk ka qenë shumë e nevojshme të ekzistojnë në këtë dokument. Të gjithë ceku se disa projekte duhet të konkretizohen dhe të dihen saktë se ku do të kryhen këto projekte. Në kuadër të këtij projekti duhet t'i jepet prioritet ruajtjes së tokës bujqësore. Lidhur me rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa që kanë të bëjnë me zonën e tetë, kërkoi të dihet se si është bërë ky ndryshim kur duhet pas parasysh faktin se pëlgimi i ministrisë së linjës ka qenë që kjo zonë të jetë ndërtimore, kurse komiteti ka rekomanduar që kjo zonë të jetë zonë e gjelbër. Andaj nëse vërtet duam që t'i japim prioritet zhvillimit, atëherë le të mbetet kjo zonë ashtu siç e ka përcaktuar ministria që kjo zonë të jetë ndërtimore dhe hapet mundësia për zhvillimin e aktivitetit biznesor. Kjo duhet të bëhet edhe për faktin se prona ku ekziston mospajtimi për katër vite i është mohuar e drejta për të ndërtuar për shkak se mu në atë pronë ka pasur uzurpim, dhe se kjo çështje ishte bërë edhe mediale, kur vetë Kryetari i Kuvendit të Kosovës kishte marrë pjesë kur kjo pronë ishte liruar nga uzurpimi dhe i ishte dorëzuar pronësia pronarit të ligjshëm pas zhvillimit të procedurave të privatizimit. Ai shtoi se ne kemi shumë prona, të cilat i kemi dhënë në shfrytëzim me qëllim të zhvillimit ekonomik, dhe tanë një biznes i caktuar të pengohet duke mos i lejuar që të ndërtojë në pronën e tij, kjo nuk ka kuptim. Mandej lidhur me vendimin e gjykatës ku thuhet që të bëhet bartja e stacionit të autobusëve në zonë të tetë, atëherë kjo është një absurd dhe në të njëjtën kohë është një shpërdorim i kompetencave ligjore nga ana atij gjyqtari, sepse nuk mund që një gjykatës të vendosë se ku do të vendoset stacioni i autobusëve, sepse kjo kompetencë i takon kuvendit të komunës në bashkëpunim me autoritet qendrore të Republikës së Kosovës. Në vazhdim ai vlerësoi se për këtë çështje duhet të jap mendimin kryetari i komunës i cili është përgjegjësi i parë për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës, dhe apeloi që për këtë dokument i cili është çështje kapitale për komunë të gjendet konsensusi politik i të gjithëve, që të ketë harmoni dhe të lejohet që në këtë pronë të ndërtohet me qëllim që t'i jepet mundësia zhvillimit ekonomik. Në fund ai tha se nuk ka kurrfarë paragjykim i ndaj askujt, por është i pajtimit që të shtyhet përpara procesi dhe të gjendet konsensusi harmonik në bashkëpunim edhe me kryetarin e komunës, por me kusht që në atë pronë ku një biznes ka zgjedhur të investojë rreth 4 milionë euro t'i lejohet mundësia që të ndërtojë në pronën e tij dhe t'i jepet mundësia zhvillimit ekonomik dhe punësimi të të rinjve të komunës sonë.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit - tha se ne nuk mund të ndryshojmë qëndrimin për faktin se ky dokument nuk ka ndryshuar në asnjë pikë nga mbledhja e kaluar e kuvendit, bile në mbledhjen e kaluar ishte thënë se edhe "100 herë" ky dokument të shqyrtohet ky prapë do të jetë i njëjtë i pandryshuar. Të gjithë ceku se drejtoria kompetente që ka hartuar këtë plan, nuk i ka përmirësuar as gabimet teknike, të cilat anëtaret e kuvendit i kishin dhënë në mbledhjen e kaluar të kuvendit. Në vazhdim ajo deklaroi se është kategorikisht kundër rekomandimeve të KPF-së e sidomos tek rekomandimi ku bëhet fjalë për kalimin e kompetencave nga kuvendi tek drejtoria për ndërrimin e destinimit të tokave. Gjithashtu është kundër që nga vendi i quajtur ura e lumit "Silmica" e deri tek tregu të jetë zonë ndërtimore me etazhitë 4 deri në 5, ndërsa tek pika siç ajo iu referua më e nxeh të apo zona e tetë, e cila ka ardhur prapë me propozimin e njëjtë, atëherë edhe për këtë është kundër përfaktin se është skeptike që këta persona njëmend dëshirojnë ta mbrojnë këtë pronë duke e lënë të gjelbër, por qëllimi është që biznesit i cili ka

shprehur gatishmërinë që të investojë t'i bëhet i pamundur ky investim. Në fund tha se është për t'u çuditur fakti se si një biznesi siç është "Emona" pengohet në komunën tonë kur ky biznes është mjaft i suksesshëm edhe në komunat tjera, andaj në shenjë solidariteti me të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit, të cilët janë kundër këtij plani, për shkak të tendencës që dikush të përfitojë dhe dikush të dëmtohet, si dhe duke mos dashur të jetë pjesë e një takimi ku do të votohej jo një plan zhvillimor "por një plan i individëve të caktuar" ajo në mënyrë demonstrative lëshoi mbledhjen e kuvendit duke deklaruar se "një ditë historia do t'i dënojë të gjithë ata të cilët e bëjnë një plan për individ të caktuar dhe jo një plan zhvillimor komunal".

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së - tha se shihet që parafolësja e tij nuk e ka lexuar as edhe një "germë" të dokumentit për të cilin po diskutohet, dhe shtoi se është mjaft shqetësuese, që është bërë trend që njerëzit që i takojnë sferës publike deklarohen publikisht duke vu etiketa për tjerët, duke e keqpërdor lirinë e shprehjes. Në vazhdim ai paraqiti një përbledhje lidhur me procesin e hartimit të Planit zhvillimor komunal, duke dhënë shpjegime për kuadrin ligor në fushën e planifikimit urban, si dhe dha sqarime sa i përket fushës së planifikimit të komunës në periudhën 2016-2024 konform normave të parapara me Planin zhvillimor komunal. Në fund tha se është për keqardhje se si anëtarët e kuvendit asnjëherë nuk kishin marrë pjesë në të gjitha ato takime, diskutime publike që ishin zhvilluar për këtë plan, dhe tani deklarohen me tone të ndryshme, me akuza dhe etiketa të ndryshme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se në bazë të ligjit të ri për planifikimin hapësinor, komunat kanë obligim që të hartojnë Planin zhvillimor komunal nga fillimi, d.m.th duhet të bëhet plani i ri, dhe për këtë është dashur që të mbahet një mbledhje e veçantë për heqjen e termit "revidim" nga titulli i këtij dokumenti. Pastaj ceku se mbledhja e kaluar ishte shtyrë me arsyetimin se materiali ishte në kopje elektronike CD, dhe ishte kërkuar që ai të jetë në kopje fizike dhe kjo u bë. Tani ndodhemi para një momenti vendimtar të aprovimit të këtij dokumenti, dhe vlerësoi se vërejtjet teknike dhe ato përbajtjesore që u dhanë janë të arsyeshme dhe të mirëseardhura në kuptimin e propozimeve për plotësimin e këtij dokumenti. Tutje shtoi duke i sugjeruar Drejtorisë së Urbanizmit që vërejtjet e bëra nga kuvendi t'i analizojë faqe për faqe dhe nëse ato janë të bazuara, atëherë ato t'i inkorporojë në plan. Lidhur me propozimet që kanë ardhur nga KPF-ja a duke u lëshuar në përbajtjen e tyre, dhe duke iu referuar asaj që ai duhet të deklarohet për këtë plan, ceku se ai është një individ i cili nuk ka të drejtë vote në kuvend, por që si Kryetar i komunës është në ballë të procesit për zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës. Në këtë kuadër ai ka punuar që të bëjë të mundur zhvillimin e qytetit dhe të komunës në përgjithësi në rrafshin urban, në këtë logjikë në të kaluarën kuvendi ka aprovuar planin urban dhe tri plane rregulluese urbane për tri zona, dhe deri më tani është punuar në bazë të këtyre dokumenteve, dhe ceku se edhe në atë kohë ishte deklaruar se më mirë do të ishte të aprovohej një dokument jo i mirë urban se sa të mos kemi fare. Në kuadër të dokumenteve të cekura më lartë vlerësoi se është punuar mjaft duke u bërë i mundur zgjerimi i rrugëve, por janë bërë edhe shpronësime, si dhe janë ndërtuar edhe projekte, mandej në disa raste janë bërë edhe rrënime dhe përfundimisht janë bërë punë dhe ndryshime pozitive brenda kapaciteteve dhe mundësive. Pastaj vlerësoi se është tepër me rëndësi që ky dokument të aprovohet me konsensus politik duke u marrë vesh për secilën pikë veç e veç. Propozimi që të mbeten zona të gjelbra vendet e quajtura tek "Vneshta" dhe "Shelgjet e Hasan Musës" ceku se duhet të kemi konkretizim të saktë se cilat parcela do të mbeten të gjelbra. Rekomandimi i tretë i cili thotë: të bëhet planifikimi i ndërtimit të një Qendre të mjekësisë familjare tek ish-ambulanta e vjetër, pasi në atë vendbanim kemi koncentrim të popullatës, ku konsideron se është propozim me vend, por këtu duhet të përcaktohet parcela se ku do të ndërtohet kjo qendër, si dhe duhet ditur se në atë territor a kemi pronë publike apo private sepse nëse prona është private, atëherë duhet të bëjmë shpronësim i cili komunës i kushton. Rekomandimi tjetër për ndërtimin e një ngrohtoreje për qytetin duke e shfrytëzuar avullin e termocentralit "Kosova B", kjo është mirë të analizohet që të ndërtohet një qendër shpërndarëse e avullit dhe për këtë duhet të caktohet një hapësirë. Mandej rekomandimi që ka të bëjë me vijën ndërtimore tek

lumenjtë të jetë 10 metra dhe ky është propozim i qëlluar, por kjo çështje do të konkretizohet edhe më mirë kur të aprovohet harta zonale. Zona e tretë e përfshirë në ndërtim me etazhitet 6 dhe 7 kate, si dhe propozimi që nga ura e lumit "Silnica" e deri tek tregu të jetë zonë ndërtimi me etazhitet 4 deri 5, në këtë rast e kemi rekomandimin e ministrisë që etazhiteti nuk mund të përfshihet në PZHK, dhe në këtë rast jemi të përkushtuar që të punojmë mbi baza ligjore. Rekomandimi tjetër që tokat bujqësore të mbesin tokë ndërtimore t'i jepet mundësia drejtorisë, në këtë kontekst propozoi që të autorizohet Drejtoria për Kadastër që në mënyrë automatike t'i shndërrojë tokat bujqësore në tokë ndërtimore në bashkëpunim me Drejtoren e Bujqësisë. Në këtë kontekst vlerësoi se do të ishte mirë që të gjitha ato hapësira që komuna i ka shpallur zonë të interesit të përgjithshëm përmes këtij kuvendi në të kaluarën, ka munguar veprimi që këto hapësira të evidentohen edhe në librat kadastral, andaj nëse ky veprim ka qenë dhe është ligjor atëherë këtu nuk ka asgjë të keqe që kjo të kryhet nga Drejtoria e Kadastrit, sepse kjo do të mundëson që këto prona të mos shiten nga ana e AKP-së. Rekomandimi tjetër që të planifikohet ndërtimi i shtëpisë muze i veprimitarit "Hasan Prishtina" kjo le të jetë pjesë e PZHK-së. Tutje shtoi se ideja për ndërtimin e një muzeliumi për eshrat e "Hasan Prishtinës" tek ish objekti i KEK-it përbull shtëpisë së "Mahmut agë Gjinollit", kishte me qenë e rëndësishme, ndërsa për ndërtimin e shtëpisë muze për veprimitarin "Hasan Prishtina" kishte me qenë mirë që të merret plani i atij objekti (shtëpisë), nga ku kishte dal për herë të fundit "Hasan Prishtina" kur ishte vrarë në Selanik të Greqisë. Planifikimi i ndërtimit të fushave sportive, kishte me qenë mirë që kjo pikë të analizohet, dhe të merret si propozim që këto hapësira sportive të ndërtohen në lokalitetin afér burgut të Smrekonicës, ku këto prona janë disahektareshe dhe janë në pronësi komunale. Në po të njëtin lokalitet aty afér është ideuar që të ndërtohet një impiant për trajtimin e ujërave të zeza, për faktin se aty gjendet pika më e ulët territoriale e komunës dhe ky projekt parashihet që të zhvillohet në të ardhmen. Sa i përket ndërtimit të fushave sportive është mirë që të mendohet që këto projekte të bëhen në hapësirat e tokës prej 200 ha që janë aktualisht në pronësi të Ministrisë së Drejtësisë që ndodhen në fshatrat Smrekonicë dhe Banjskë (për këtë çështje mbetet të vendosë kuvendi i komunës). Ndërsa sa i përket zonës së tetë, njoftoi se Komuna e Vushtrrisë ka probleme pronësore sa i përket ish-ndërmarrjes Kosova Trans apo stacioni i autobusëve, ku siç dihet që me një vendim të Qeverisë së Kosovës kjo ndërmarrje i ishte kthyer në pronësi komunës, mirëpo në bazë të vendimit të gjykatës doli që në mënyrën se si i ishte dhënë me të gjitha ato obligime, komunës nuk i shërben gati se asgjë, ku bëhet fjalë me mbi 4 milionë euro obligime që është dashur komuna t'i paguajë për atë stacion, kurse me 1 milion komuna mund të blejë hapësire dhe të ndërtojë këtë stacion. Në këtë drejtim është bërë reagim nga Zyra ligjore e komunës që komuna mos të gjobitet për faktin se nuk ka qenë subjekt në këtë kontest dhe deri më tanë kemi pasur sukses. Lidhur me këtë problematikë kishte alarmuar institucionet qendrore për mundësinë e ndryshimit të ligjit, por për këtë çështje kishte biseduar me zyrtarët e AKP-së dhe me zyrtarë tjerë qeveritarë për mundësinë e gjetjes së një marrëveshjeje. Zyrtarëve të AKP-së, njoftoi se iu kishte thënë që të marrin përsipër që ta zgjidhin kontestin dhe që kjo ndërmarrje t'i dorëzohet komunës pa obligime, mirëpo për këtë ata nuk kanë pasur gatishmëri. Lidhur me propozimin që stacioni i autobusëve të futet (bartet) në zonën e tetë, këtë propozim le ta vlerësojë vetë kuvendi. Po ashtu në hapësirën e zonës së tetë, ndodhet edhe ish - restoranti "Vicianum", dhe kjo pronë i është dhënë në shfrytëzim Ministrisë së Drejtësisë, dhe në këtë kuadër dihet fakti se Komuna e Vushtrrisë i ka dal në mbështetje kësaj ministrie duke i dhënë prona për ndërtimin e objektit të gjykatës dhe të Akademisë policore, kurse ne si komunë kur kemi kërkuar mbështetje nga ana e tyre ata nuk na janë përgjigjur. Andaj pronat e cekura me lartë përfshihen në zonën e tetë dhe komuna ka interes që këto prona t'i kthejë në pronësi komunale përmes formave ligjore. Gjithashtu edhe disa prona tjera të cilat pretendon AKP-ja t'i privatizoje, ne jemi të interesuar që këto prona në forma ligjore t'i kthejmë në pronësi komunale. Lidhur me këto prona, komuna ka bërë kërkesë në qeveri që këto prona t'i kthehen komunës, apo që të bëjmë këmbim pronash, si dhe që disa nga to të na dhurohen për faktin se ne iu kemi ndihmuar

në të kaluarën institucioneve qendrore sa i përket gjetjes së hapësirave. Pastaj vlerësoi se propozimi i fundit për zonën e tetë është që ajo të jetë ndërtimore, dhe dihet fakti se edhe në të kaluarën në atë pjesë është bërë biznes sepse aty ka qenë Kooperativa, mirëpo pavarësisht kësaj, propozimi i KPF-së ka qenë i kundërt me këtë të parin. Në anë tjetër është e vërtetë që biznesi "Emona" ka shprehur interesimin për të ndërtuar një objekt biznesi (market) dhe atyre askush nuk mund t'ua mohojë të drejtën që të parashtrojnë kërkesë për leje ndërtimore në Drejtorinë e Urbanizmit, kurse aktualisht ky biznes kërkon që në PZHK kjo parcelë të mos futet si hapësirë gjelbëruese, por të jetë zonë ndërtimore. Në fund tha se për të aprovuar këtë dokument kemi "përpara" tri propozime: Propozimin që e ka ofruar qeveria komunale, propozimin që e ka bërë Komiteti për Politikë dhe Financa, si dhe propozimi që vjen nga biznesi "Emona". Andaj iu apeloi anëtarëve të kuvendit që të gjejnë një konsensus mes veti që ky dokument të aprovohet me unanimitet të plotë, apo në të kundërtën propozoi që të kemi shtyrje të aprovimit të këtij plani deri në gjetjen e një marrëveshjeje mes grupeve politike.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit - pasi e përgëzoi drejtorinë për punën që ka bërë në hartimin e Planit zhvillimor komunal, ceku se ne të gjithë së bashku duhet të bëjmë përpjekje që të bëjmë më të mirën e mundshme për qytetarët tanë. Pastaj shtoi se kur flasim për zonën e tetë, atëherë nëse ajo mbetet zonë e gjelbër, komuna po humb shumë, kurse nëse ajo zonë mbetet ashtu siç është zonë ndërtimore, atëherë komuna do të përfitojë. Lidhur me banjën publike "hamami i qytetit" vlerësoi se nga ku janë marrë faktet se ky objekt më herët ka qenë kishë romake për faktin se kjo nuk është e qëndrueshme. Në fund deklaroi se është mirë që zona e tetë të mbetet zonë ndërtimore dhe ceku se në këtë version do të votonte për këtë plan.

Bahrije Plana, anëtare e kuvendit - tha se kur flitet për këtë plan, mund të themi se është punuar me mjaft përkushtim nga ekipi komunal i planifikimit dhe për këtë ajo i përgëzoi. Tujte shtoi se njëzet e katër (24) takime që janë mbajtur lidhur me PZHK-në, nuk janë për t'u nënçmuar, për faktin se është bërë një punë e madhe. Lidhur me konstatimin se anëtarët e kuvendit nuk kanë marrë pjesë në debatet lidhur me këtë plan ajo arsyetoi se kjo është bërë për faktin se anëtarët e kuvendit propozimet e tyre i kanë dhënë në mbledhjet e KK-së dhe të KPF-së. Mandje ceku se rekomandimet që janë dhënë në KPF nuk janë marrë për bazë, sepse ky dokument ka gabime teknike dhe nuk është i lektuar si duhet. Pastaj ceku se ajo në komitet, kishte mbajtur qëndrimin që ky dokument (plan) të procedohet për kuvend, mirëpo ajo edhe në komitet kishte deklaruar, që anëtarët e KPF-së dhe të kuvendit nuk duhet që gjatë aprovimit të këtij dokumenti të lëshohen në interesa private dhe individuale, kur dihet fakti se disa nga anëtarët e kuvendit kanë bizneset e tyre private dhe këtu nuk duhet të kemi gërshetim interesash. Në vazhdim ajo apeloi që ky dokument të aprovohet sot sepse në të është punuar shumë, por kishte me qenë mirë që për një dokument kaq të rëndësishëm të kemi konsensus të plotë politik, dhe gjithashtu të merren për bazë interesat e qytetarëve duke iu lejuar biznesit "Emona" që të ndërtojë objektin tregtar për të cilin ka kërkuar.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se ne i kemi dhënë prona Ministrisë së Drejtësisë për ndërtimin e dy objekteve, dhe tani ajo nuk është e gatshme që të japë në pronësi objektin e ish restorant "Vicianumit", atëherë pse kjo ministri nuk është kushtëzuar kur i janë dhënë këto prona. Tani jemi në një situatë kur Ministria e Mjedisit ka dhënë pëlqimin që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore, kurse propozimi i KPF-së është që kjo zonë të jetë e gjelbër. Andaj lidhur me këtë ai propozoi që për t'u arritur konsensusi politik, atëherë duhet që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore - zonë biznesi dhe në këtë formë ky dokument do të aprovohej nga të gjitha grupet politike të përfaqësuara në kuvend. Në fund tha se nëse veprohet ndryshe atëherë nuk do të ketë konsensus dhe ky plan do të aprovohej në kundërshtim me interesat e qytetarëve.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se kryetari i komunës ka paraqitur projektin e Planit Zhvillimor Komunal, ku parashev që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore, pastaj kemi propozimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, që këtë zonë e lë ashtu siç ka qenë, duke mos e trajtuar dhe kemi edhe një propozim që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje të radhës derisa të arrihet një marrëveshje mes grupeve politike në kuvend. Në vazhdim ai apeloi

për një konsensus politik në interes të qytetarëve. Tufje shtoi se të gjithë së bashku duhet të përpinqemi që gjemjë zgjidhje që janë oportune dhe që i shërbijnë interesit të përgjithshëm dhe jo të biem pre e interesave të ngushta individuale. Pastaj ai vlerësoi se në mesin e këtij kuvendi, kemi njerëz shumë të dëshmuar të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar në të kaluarën dhe ata individ janë nga të gjitha grupimet politike, në këtë kontekst vlerësoi se dikur gjatë historisë kur njerëzit frikoheshin ta përmendin fjalën “republikë” dolën në skenë njerëz që e shpalen republikën duke aluduar në anëtarin e kuvendit Muharrem Shabani. Në fund ai deklaroi se do ta mbështes propozimin e ofruar nga kryetari i komunës.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës - tha se kur bëhet fjalë për kushtëzimin që duhet t'i bëhet Ministrisë së Drejtësisë për sa i përket pronave njoftoi se prona tek Gjykata Themelore-Dega e Mitrovicës parashihet që në të ardhmen ajo pronë t'i takojë komunës, në këtë logjikë është bërë këmbimi i pronave në atë kohë mes komunës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Në fund tha se qëndrimi i tij përfundimtar lidhur me PZHK-në është që të gjendet konsensusi politik mes subjekteve politike kurdo që të jetë i mundur që të arrihet.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se disi sikur nuk po futemi në problemin real që ekziston dhe kështu sikur po krijojmë dilema dhe mjetëzues përfundimtar që nuk ka qëndrim real dëshiron me vite dhe kanë ekzistuar makina bujqësore, tanë kjo tokë të shndërrrohet në zonë gjelbërimi kjo është krejt e pakuptimit. Pastaj shtoi se komiteti, deklarohet ndryshe, qeveria gjithashtu është me qëndrime të ndryshme dhe tanë kuvendi nuk e ka të ditur se si do të votojë. Në vazhdim apeloi tek të gjithë që të kemi një qëndrim real dhe të drejt pavarësisht interesave të ngushta sepse nga ky dokument zhvillimor varet edhe zhvillimi i gjithmbarshëm i komunës. Në fund vlerësoi se si kuvend nuk duhet të marrim vendime të ngutshme, të cilat në instancë të fundit do të mund të dëmtonin interesin e qytetarit tanë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se lidhur me zonën e tetë të cilën e cilësor si problematike, shtoi se rekomandimet e dala nga Komiteti për Politikë dhe Financa nuk paraqesin obligim për kuvendin, dhe në këtë kontekst duhet bërë të ditur diçka më të rëndësishme dhe më obliguese sesa kjo e fundit, dhe ajo se ky draft-plan i ka kaluar procedurat nëpërmes Ministrisë së Mjedisit, dhe kjo ministri e kishte dhënë pëlqimin e saj pasi e ka marrë ndryshimin e revidimit të planit dhe format tjera dhe ndër të tjera kishte thënë se në procedurë të mëtejme duhet respektuar debati që është zhvilluar me qytetarë dhe në këtë drejtim, para se gjithash duhet respektuar vendimi i kuvendit që është marrë për këtë plan, si dhe procedurat tjera që janë ndjekur deri në këtë moment konform pëlqimit të ministrisë gjegjëse. Pastaj ceku se i intereson qëndrimi i kryetarit të komunës, i cili është i pari i komunës personi kyç dhe i cili ndodhet në ballë të procesit të zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës dhe apeloi që t'i shëmangemi interesave të grupeve e individëve të caktuar por të marrim një vendim racional dhe konform interesave të qytetarëve. Në fund tha se duhet t'i kthehem debatit qytetar, konform frysë së ligjit dhe institucionit që t'i mundësojmë edhe biznesit të sipërcekur që të zhvillojë veprimtarinë e tij biznesore.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se lidhur me Planin zhvillimor komunal, janë mbajtur dy apo tri takime të KPF-së, ku janë dal disa rekomandime, të cilat janë plotësuar më herët, por janë edhe rekomandimet e mbledhjes së fundit të cilat nuk janë plotësuar në këtë dokument. Pastaj vlerësoi se herëve tjera kishte pasur vërejtje se nuk po respektohen rekomandimet e KPF-së. Sa i përket rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, atëherë kemi tentuar që të mbrohet interes publik e jo diçka tjeter. Tufje shtoi se jemi në dijeni se mbi komunë rëndon një obligim financiar prej mbi 4 milionë euro, sa i përket stacionit të autobusëve dhe pikërisht për këtë kemi menduar që zona e tetë deri tek zgjidhja e këtij kontesti kjo zonë të mbetet kështu, dhe pas një periudhe prej 3 apo 4 muajsh kur të zgjidhet ky kontest atëherë kjo çështje do të mund të procedohej në kuvend për trajtim.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për” 13 vota “kundër” të tjerat abstenim aprovoi rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të dala nga mbledhja e datës 09.12.2016:

- Zona e tetë (8) të mbetet ashtu qysh ka qenë në PZHK të vitit 2009, por me një ndryshim të vogël, që shenja e Stacionit të Autobusëve të zhvendoset nga pronat kontestuese, të cilat ligjërisht gjykata i ka shpallur me pronarë faktik dhe në tekst të përshkruhet që stacioni i autobusëve të vendoset brenda zonës tetë (8);
- Gjelbërimi të mbetet në një pjesë, në vendin e quajtur “Vneshtat”, si dhe te “Shelnjet e Hasan Musës”;
- Të bëhet planifikimi për ndërtimin e një Qendre të mjekësisë familjare, prapa “Ambulantës së vjetër” pasi që ajo pjesë e qytetit ka një koncentrim të madh të banorëve dhe do të paraqitet nevoja për ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
- Të planifikohet ndërtimi i një ngrohtoreje të qytetit, duke shfrytëzuar avullin e Termocentralit “Kosova B”. Kjo për shkak që koncentrimi i banorëve në qytet është në trend të rritjes dhe ka nevoja të mëdha për ofrimin e këtij shërbimi;
- Tek të gjithë lumenjtë (që kanë qasje në qytet ose periferi të qytetit) të vendoset distanca mes shtratit të lumenjve dhe vijës ndërtimore 10 metra në të dyja anët e shtratit të lumenjve;
- Rruga prapa te “bankinat” të rregullohet (drejtohet) dhe t'u jepet mundësia e barabartë për qasje në këtë rrugë të gjithë shfrytëzuesve të kësaj zone;
- Tokat bujqësore, të cilat mbisin tokë ndërtimore, t'i jepet mundësia Drejtorisë për Kadastër në mënyrë automatike ta shndërrojë në tokë ndërtimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë;
- Drejtoria për Kadastër ta ketë mundësinë e ndarjes së parcelave, bashkimin e parcelave në tokat bujqësore, gjegjësish tokave që janë nën komasacion (sistem të ujites);
- Të planifikohet ndërtimi i shtëpisë muze i veprimtarit Hasan Prishtina;
- Të planifikohet ndërtimi i fushave sportive.

Pas votimit të rekomandimeve nga ana e kuvendit, grupet kuvendare të LDK-së, LVV-së, anëtarë i kuvendit nga radhët e AAK-së si dhe anëtaret tjerë të pavarur në mënyrë demonstrative e lëshuan mbledhjen e kuvendit.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se ne tani e votuam një propozim i cili kishte ardhur nga Komiteti për Politikë dhe Financa, si dhe e kemi një propozim tjetër të qeverisë komunale që ka ardhur me Planin zhvillimor komunal, por i cili nuk u mor për bazë, atëherë si rezultat i kësaj ai deklaroi se nuk do të jetë pjesë e mbledhjes së kuvendit.

Sqarim:

Para fillimit të votimit të Planit zhvillimor komunal, kryesuesi i kuvendit Shpëtim Zhegrovë, konstatoi se në sallë ishin prezent 19 anëtarë të kuvendit (kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme). Pastaj kryesuesi i kuvendit e hodhi në votim Planin zhvillimor komunal ku 15 anëtarë të kuvendit votuan për, të tjerët abstenuan.

Vërejtje:

Dy anëtarë të kuvendit, Qerim Selimi dhe Shaban Beka, në momentin kur kishte filluar votimi filluan të dalin nga salla e kuvendit.


Kështu që pas ndërprerjes së mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë të datës 12.01.2017, Sekretaria e Kuvendit, i kishte dërguar Ministritë së Administrimit të Pushtetit Lokal të gjitha materialet audio dhe vizuale të mbledhjes në ç'rast kjo ministri kishte konstatuar me sa vijon:

Në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të mbajtur më datë 12.01.2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përkatësisht Departamenti Ligjor dhe Monitorimi i Komunave, ka konstatuar se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;

Lidhur me këtë çështje zyrtarisht është njoftuar Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me shkresën njoftuese me Nr.0-129 më datë 25.01.2017, kurse pas këtyre vlerësimeve të bëra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kryesuesi i kuvendit nuk e kishte nënshkruar vendimin lidhur me aprovin e Planit Zhvillimor Komunal.

Duke u bazuar në vlerësimet e Ministritë së Administrimit të Pushtetit Lokal ku ishin gjetur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, është konstatuar se për këtë mbledhje mungonte kuorumi për vazhdimin e mbledhjes dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj në këtë rast konsiderohet se mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 12.01.2017 ishte ndërprerë në ora 12:30.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrovë



Kryesues i Kuvendit